



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 505/5 Prot.

Tiranë, më 07.11. 2018

**VENDIM**

Nr.86, datë 07/11/2018

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË  
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË BASHKINË HAS DHE  
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E  
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Has,

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin nr. 63, datë 07.06.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Has”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Bashkia Has.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 505/1 prot., datë 07.06.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 505/2 prot., datë 07.06.2018, “*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*”, i është njoftuar Bashkisë Has.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 505/3, datë 11.10.2018, “*Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në Bashkinë Has, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, duke i lënë një afat **15** ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr. 1914/1 prot., datë 29.10.2018, të Kryetarit të Bashkisë Has, “*Kthim përgjigje*”, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, bashkëlidhur edhe observacionin, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i mbikëqyrjes, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”,

miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### VENDOSA:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Has dhe të paralajmërojë institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Me qëllim realizimin e një strukture organizative të qëndrueshme, për vitin 2019, e në vijim, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe duke respektuar kompetencat ligjore të përcaktuara në ligjin për vetëqeverisjen vendore, gjatë procesit të hartimit të strukturës së bashkisë, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të veprojë duke ndjekur këtë radhë pune:
  - ✓ Gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucionit për vitin në vijim, të zbatohet skema e funksionimit të shërbimit civil, në përputhje me nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të sigurohet aplikimi i të gjitha instituteve të ligjit, duke u orientuar në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, në rubrikën që i përket këtij aspekti.
  - ✓ Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në strukturën pasardhëse të institucionit duhet të përcaktojë pozicionet e shërbimit civil, duke i ndarë nga pozicionet që do të kryejnë funksione politike dhe nga pozicionet që nuk ushtrojnë funksion publik (*punonjësit administrativ*) dhe t'i përshtatë detyrat dhe funksionet e pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, si dhe me ligjet që rregullojnë çdo sektor të veprimtarisë së bashkisë.
  - ✓ Për pozicionet e punës me emërtesën “*Audit i brendshëm*”, “*Jurist*”, “*Kontabilist*” dhe “*Llogaritar page*”, njësia përgjegjëse të saktësojë emërtesat e pozicioneve të punës, duke përcaktuar qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë që realizon çdo pozicion pune dhe për rastet e vlerësuara në kategorinë e nëpunësit civilë, të hartojë formularët e përshkrimit të punës dhe të zbatohen kërkesat ligjore për plotësimin e këtyre pozicioneve.

- ✓ Njësia e auditimit të brendshëm, të organizohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar; të vendimit nr. 83, datë 03.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, me qëllim që të evidentohen pozicionet e shërbimit civil sipas kategorisë, klasës së pozicionit dhe kategorisë së pagës.
  - ✓ Pozicionet e punës me emërtesën: “Inspektor blegtorie”, “Inspektor i mbrojtjes civile (emergjencave)” dhe “Inspektor arkivi”, pjesë e organikës së administratës së bashkisë qendër, njësia përgjegjëse duhet t’i përfshijë në skemën e shërbimit civil dhe të marrë masa për plotësimin e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
  - ✓ Pozicionet e punës me emërtesën: “Inspektor blegtorie”, “Inspektor bujqësie”, “Inspektor pyjesh”, “Specialist i ndihmës ekonomike” dhe “Inspektor i mbrojtjes civile”, pjesë e organikës së njësive administrative, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë qartësisht detyrat teknike dhe përgjegjësitë që realizon çdo pozicione pune dhe më pas, të përcaktojë nëse këto pozicione do të përfshihen në skemën e shërbimit civil.
  - ✓ Njësia përgjegjëse duhet të drejtojë procesin për hartimin e rregullores së brendshme të institucionit, në të cilën duhet të pasqyrohen qartë ndryshimet e mësipërme, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo pozicion pune, duke specifikuar pozicionet e punës për të cilat marrëdhënia e punësimit rregullohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe ndryshimet ligjore dhe ndryshimet strukturore të institucionit.
3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Has, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet të finalizojë procesin e deklaramit të statusit të punësimit, duke nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, si “Nëpunës civilë”, sipas procedurave specifike të përcaktuara në ligj, për punonjësit si më poshtë:
1. \*\*\*\*\*, punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Ekonomik dhe Investimeve”, në Bashkinë Has, emëruar me urdhrin nr. 58, datë 30.11.2011 të Kryetarit të Bashkisë;
  2. \*\*\*\*\*, punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave”, në Bashkinë Has, emëruar me urdhrin nr. 33, datë 02.08.2011 të Kryetarit të Bashkisë;



- ✓ Të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësen \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektor arkivi*”, duke evidentuar faktin se kjo punonjëse, nuk plotëson kriterin për të qenë nëpunës civil, konkretisht kriterin arsimor, pasi ajo nuk zotëron arsimin përkatës në përputhje me kriteret e pozicionit të punës.

6. Kryetari i Bashkisë Has, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit dhe asaj financiare me institucionin, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit, të nxjerra nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\*, “*Sekretar i Përgjithshëm*”, emëruar me urdhrin nr. 280, datë 07.05.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
2. \*\*\*\*\*, “*Kontabiliste*”, në Sektorin Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 29, datë 12.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
3. \*\*\*\*\*, “*Specialist finance*”, në Sektorin Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 87, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
4. \*\*\*\*\*, “*Inspektor*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore, emëruar me urdhrin nr. 1, datë 03.01.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
5. \*\*\*\*\*, “*Inspektor*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, emëruar me urdhrin nr. 87/5, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
6. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës i Sektori të Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës*”, emëruar me urdhrin nr. 22, datë 19.05.2014, të Kryetarit të Bashkisë;
7. \*\*\*\*\*, “*Inspektor i pronave*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 56/3, datë 12.05.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
8. \*\*\*\*\*, “*Inspektor i emergjencave*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 87/4, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
9. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës i Sektori të Mbrojtjes, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*”, emëruar me urdhrin nr. 188, datë 23.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
10. \*\*\*\*\*, “*Inspektor MMT dhe MK*”, në Sektorin e Mbrojtjes, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 87/6, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
11. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave*”, emëruar me urdhrin nr. 56, datë 10.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
12. \*\*\*\*\*, “*Inspektor taksa-tarifë*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave, emëruar me urdhrin nr. 63, datë 10.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
13. \*\*\*\*\*, “*Inspektor taksa-tarifë*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave, emëruar me urdhrin nr. 416, datë 18.10.2017, të Kryetarit të Bashkisë;

14. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, emëruar me urdhrin nr. 1, datë 04.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
15. \*\*\*\*\*, “Specialist i burimeve njerëzore”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 121, datë 24.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
16. \*\*\*\*\*, “Specialist statistika dhe komunikim me media”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 245, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
17. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit Juridik”, emëruar me urdhrin nr. 108, datë 30.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
18. \*\*\*\*\*, “Jurist”, në Sektorin Juridik, emëruar me urdhrin nr. 44/1, datë 30.03.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
19. \*\*\*\*\*, “Inspektor Sporti”, në Sektorin e Kulturës dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 184/1, datë 23.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
20. \*\*\*\*\*, “Inspektor arsimit”, në Sektorin e Kulturës dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 253, datë 07.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
21. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Shërbimeve Publike”, në Sektorin e Shërbimeve, emëruar me urdhrin nr. 109, datë 30.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
22. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Bordit të Kullimit”, në Sektorin e Shërbimeve, emëruar me urdhrin nr. 134, datë 30.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
23. \*\*\*\*\*, “Specialist”, në Bordin e Kullimit, emëruar me urdhrin nr. 161, datë 11.04.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
24. \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve”, emëruar me urdhrin nr. 59, datë 29.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
25. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 60, datë 29.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
26. \*\*\*\*\*, “Specialist i pyjeve dhe kullotave”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 75, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
27. \*\*\*\*\*, “Specialist i kadastrës dhe GIS”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 61, datë 29.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
28. \*\*\*\*\*, “Specialist”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 76, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
29. \*\*\*\*\*, “Specialist”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 63, datë 29.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë.
30. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Ndihmës Ekonomike”, në njësinë administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 87, datë 30.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
31. \*\*\*\*\*, “Specialist i Ndihmës Ekonomike”, në njësinë administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 99, datë 06.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
32. \*\*\*\*\*, “Inspektor territori”, në njësinë administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 84, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
33. \*\*\*\*\*, “Inspektor blegtorie”, në njësinë administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 31, datë 15.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
34. \*\*\*\*\*, “Inspektor bujqësie”, në njësinë administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 32, datë 15.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
35. \*\*\*\*\*, “Inspektor i mbrojtjes civile”, në njësinë administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 27, datë 12.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
36. \*\*\*\*\*, “Inspektor pyjesh”, në njësinë administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 91, datë 30.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë;

37. \*\*\*\*\*, “*Specialist finance dhe arkivi*”, në njësinë administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 17, datë 11.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
38. \*\*\*\*\*, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 43, datë 21.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
39. \*\*\*\*\*, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 106/3, datë 13.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
40. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor pyjesh*”, në njësinë administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 3, datë 04.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
41. \*\*\*\*\*, “*Inspektor i emergjencave civile*”, në njësinë administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 86/1, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
42. \*\*\*\*\*, “*Inspektor bujqësie*”, me urdhrin nr. 461, datë 30.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
43. \*\*\*\*\*, “*Specialist finance dhe arkive*”, në njësinë administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 444, datë 14.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
44. \*\*\*\*\*, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 13.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
45. \*\*\*\*\*, “*Inspektor pyjesh*”, në njësinë administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 21, datë 11.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
46. \*\*\*\*\*, “*Inspektor i emergjencave civile*”, në njësinë administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 17, datë 13.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë.

✓ Njësia përgjegjëse, të planifikojë ecurinë e kësaj procedure me faza, me qëllim që konstatimi si akte absolutisht të pavlefshëm prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.

✓ Dokumenti i planit të veprimit në këtë rast do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, brenda afatit të paralajmërimit dhe më tej do të ndiqet zbatimi i tij nga Sekretariati i Komisionerit, sipas afateve të vendosura në këtë akt.

7. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit gjatë vitit 2019, për të zbatuar detyrimin ligjor të respektimit të skemës së funksionimit të shërbimit civil, parashikuar në



nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil. Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të njohë të gjithë aktorët e procesit të hartimit të përshkrimeve të punës me vendimin e Komisionerit, pasi në rast të moszbatimit të detyrave të lëna nga Komisioneri, brenda afatit të paralajmërimit, përgjegjësia do të jetë personale për çdo nëpunës që nuk ka vepruar.

8. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Has, në zbatim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duhet të drejtojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 dhe në vijim, për të gjithë punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, duke orientuar dhe aktorët e tjerë të procesit, në rolin e zyrtarit raportues, zyrtarit kundërfirmues dhe zyrtarit autorizues, sipas orientimeve të dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të njohë të gjithë aktorët e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë me vendimin e Komisionerit, pasi në rast të moszbatimit të detyrave të lëna nga Komisioneri, brenda afatit të paralajmërimit, përgjegjësia do të jetë personale për çdo nëpunës që nuk ka vepruar

9. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Has, para se të fillojë procesin e konkurrimeve për të plotësuar vendet vakante, duhet të fillojë menjëherë procedurat për përgatitjen e planit vjetor për vitin 2019, sipas përcaktimeve të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*.

Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që plani vjetor të miratohet nga Kryetari i Bashkisë dhe të bëhet publik në faqen zyrtare të *“Shërbimit Kombëtar të Punësimit”*, në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat për informimin e publikut, në mënyrë që konkurrimet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ligji për shërbimin civil, të tillë si: numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurrimi për çdo kategori dhe klasë; rastet përjashtimore, nëse do të pranohen dhe kandidatë të tjerë për të aplikuar në procedurat e ngritjes në detyrë, si dhe kërkesa të tjera ligjore.

10. Për kryerjen e këtyre veprimeve, lihet afat **90** ditë nga marrja dijëni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

11. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Has, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
12. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
13. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Has, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Ministria e Brendshme dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**